



KUVENDI KOMUNAL I LIPJANIT, ME NISMË PËR NGRITJE PAGASH

## Kuvendarët e Lipjanit duan nga 700 euro pagë në muaj

Arian Duriqi

LIPJAN, 25 JANAR – Kuvendi Komunal i Lipjanit e ka marrë një iniciativë për rritjen e pagave dhe privilegjeve tjera të këshilltarëve komunalë, ndërsa me një propozim të tillë pritet të dalin qysh në mbledhjen e ardhshme të datës 31 janar 2012. Kuvendarët e Lipjanit, ndërkaq, pritet të propozojnë me një vendim të veçantë paga më të larta për vete, madje duke arritur një lartësi prej 700 eurosh në muaj. Dhe, 700 euro në muaj ata do t'i kërkojnë duke u bazuar në 30-përqindëshin e asaj që marrin për një muaj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës në nivel qendror. Në një propozim që është hartuar në Lipjan për trajtimin dhe të drejtat e anëtarëve të KK-së dhe që do të dalë për miratim më datën 31 të këtij muaji, në pikën 1.1. thuhet se anëtarit të KK-së që nga momenti i verifikimit të mandatit i takojnë të ardhura mujore lartësia e të cilave duhet të jetë paga bazë e anëtarit të KK-së dhe të merret 30-përqindëshi i pagës bazë të deputetëve në Parlamentin e Kosovës dhe që sipas kalkulimeve i bie diku rreth 700 euro në muaj për një këshilltar. Kjo lëvizje e lipjanasve që drejtojnë me Kuvendin e Lipjanit, ndërkaq, të mërkurën ka nxitur edhe

reagimin e ashpër të shoqërisë civile në Lipjan. Bekim Krasniqi, udhëheqës në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR) e ka quajtur absurditet këtë propozim. “Organizata joqeveritare YAHR shpreh shqetësimin lidhur me iniciativën e Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit për rritjen e të ardhurave personale si këshilltarë të Kuvendit komunal, rritje kjo që do të ndikonte drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Lipjanit”, ka thënë Krasniqi. “Sipas kalkulimeve që janë bërë në total në muaj i bie që një këshilltar t’i marrë 700 euro. Kuvendi Komunal në Lipjan i ka 31 këshilltarë, që do të thotë se do të shpenzojë në muaj 21,700.00 euro vetëm për paga, ndërsa në vit 260,400.00 euro dhe kjo s’ka asnjë kuptim”, ka shtuar ai. Për më tepër, iniciativa për rritjen e pagës së këshilltarit komunal, sipas Krasniqit, është edhe në kundërshtim me udhëzimin administrativ nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në Komuna dhe udhëzimin administrativ 01/2010, mbi kufizimet e kompensimit dhe marrjes së pagës së zyrtareve komunalë. “Këshilltarët komunalë nuk mund të krahasohen me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi volumin e punës së tyre

si deputetë. Këshilltarët komunalë të Lipjanit në bazë të monitorimit që kemi bërë janë shumë pasivë dhe nuk marrin asnjëherë iniciativë që do ta përmirësonte jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit”, ka thënë Krasniqi. Mirëpo, në versionin zyrtar të Komunës së Lipjanit propozimi në fjalë për rritje pagash e privilegjesh të këshilltarëve të KK-së interpretohet më ndryshe nga ajo që është hartuar në propozim. Dhe, përderisa të mërkurën ka qenë i pamundur kontakti me Lulzim Rustemin, kryesues në KK, nga ana tjetër Petrit Kelmendi, drejtor i Buxhetit dhe i Financave në Lipjan, ka deklaruar se këshilltarët komunalë me këtë propozim iu kanë drejtuar nivelit qendror dhe në qoftë se sipas tij niveli qendror e pranon propozimin duhet ta përcjellë edhe masën buxhetore bashkë me vendimin. Ky përjashton mundësinë që Komuna e Lipjanit të dëmtohet në buxhetin komunal për shkak të rritjes eventuale të pagave të kuvendarëve. “Secili vendim që vjen për këtë rast nga niveli qendror duhet të përcillet edhe me masën buxhetore, sepse ata duhet alokuar buxhet shtesë për këtë punë, ndryshe Komuna me buxhetin e vet s’ka mundësi të bëjë asnjë lëvizje në këtë plan”, ka thënë Kelmendi.

**Duke kundërshtuar idenë e ngritjes së pagave, Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut (YAHR) ka thënë se nëse miratohet ky propozim, kjo komunë duhet të harxhojë mbi 260 mijë euro në vit vetëm për t’i paguar këshilltarët komunalë**

### Pezullim

KLINË, 25 JANAR – Kuvendi Komunal i Klinës ka vendosur të suspenduar punën e komisionit të kontrollit të Arsimit, Kulturës dhe Sportit, pasi që kjo komisioni ka propozuar apo largimin përfaqësuesit të MASH-së nga lista e kandidatëve për të bërë pjesë në këqija. Në një vendim të kësaj note e sjelljes së komisionit pason pezullimin e punës për muaj behët me një muaj ka Komuna si alternativ të nxjerrë

### KPF-ja e

ISTOG, 25 JANAR – Komuna e Istogut ka marrë vendim për para disa ditë të pezullojë punën e komisionit të kontrollit të Arsimit, Kulturës dhe Sportit të përgjigjet mbështetur në “Dëmet e shkaktojnë njoftuar ai. Ai Komuna ka irshkaktuara nga Ademaj. Ai ka nga 7 janari. komisionet që dëmet e shkaktojnë Muhamet Kabashprehur i habet KK-së për t’u e KK-së do të... Nderkaq anëtarët e Rugova, është dhe përkushtimi këtu vetëm “K... (S.B.)

### Komu

VITI, 25 JANAR – Komuna e Vitisë ka marrë vendim për të pezulluar punën e komisionit të kontrollit të Arsimit, Kulturës dhe Sportit, pasi që kjo komisioni ka propozuar apo largimin përfaqësuesit të MASH-së nga lista e kandidatëve për të bërë pjesë në këqija. Në një vendim të kësaj note e sjelljes së komisionit pason pezullimin e punës për muaj behët me një muaj ka Komuna si alternativ të nxjerrë